



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 197

Tiranë – E Hënë, 29 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8847, datë 18.12.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11031
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 10.6.2014	Çështja “Çështja Eltari kundër Shqipërisë”- kërkesë nr. 16530/06). 11031
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 6755/9, datë 18.12.2014	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “ndërtim, tokë bujqësore, arë, truall, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 400 kV, Vau i Dejës-Morinë”..... 11034
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 7461/3, datë 18.12.2014	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë, truall”, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv, Zemblak-Korçë”..... 11037
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 7462/3, datë 18.12.2014	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore-arë, truall”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kV, Ersekë-Korçë”..... 11038
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7703, datë 19.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Pushimi i Shoferit- Divjakë”..... 11040
	Tabelat plotësuese të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 26, datë 16.12.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22.12.2014, f. 10787..... 11048

**DEKRET**

Nr. 8847, datë 18.12.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Kimete Nuha Jusufi (Hajrullahu)
2. Sebahattin Selahattin Demiryürek
3. Xhavit Sherif Ademaj
4. Flutura Muhamet Gashi (Veliu)
5. Ziad Iljas Damial (Danial)
6. Khayriya (Khairiya) Iljas (Eljas) Shakouri (Shakuri)
7. Ajnure Ibraim Abdulla (Abdula)
8. Sevde Ihsan Tokçelik (Ceyhan)
9. Kimete Muharrem Gashi (Haxhimurati)
10. Abdullah Nazmi Llapashtica
11. Hamzi Liman Kameri
12. Denizham Çelebi Barin
13. Sarah Ann Brian Lewis Wakeley (Robinson)
14. Fikret Vahip Kara
15. Hesham Hosni Awad Mousa
16. Sokol Dinë Krasniqi
17. Lumrije Midin Krasniqi (Shala)
18. Argjend Sokol Krasniqi
19. Elionis Sokol Krasniqi
20. Egzon Sokol Krasniqi
21. Abdullah Faruk Veliu
22. Fatime Tahir Peta (Marku)
23. Ali Mehmet Kocaoglu
24. Maisara Abud (Aboud) Albari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**SEKSIONI KATËRT
ÇËSHTJA ELTARI KUNDËR
SHQIPËRISË**

(Kërkesa nr. 16530/06)

VENDIM

(Shpërblimi i drejtë)

STRASBURG

10 qershor 2014

I FORMËS SË PRERË

10.9.2014

Ky vendim ka marrë formë të prerë, sipas nenit 44, paragrafi 2, të Konventës. Ai mund të rishikohet nga ana editoriale.

Në çështjen Eltari kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur si dhomë e përbërë nga:

Ineta Ziemele, presidente,
Päivi Hirvelä,
George Nicolaou,
Ledi Bianku,
Zdravka Kalaydjieva,
Krzysztof Ęojtyczek,
Faris Vehabović, gjyqtarë,
dhe Françoise Elens-Passos, Sekretar i Seksionit,

pas diskutimesh në seancë të mbyllur më 20 maj 2014,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka fillesën në një kërkesë (nr. 16530/06) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, nj. Zamira Eltari, mbiemri i lindjes Sharra (“kërkuesja”), më 25 prill 2006.

2. Në një vendim të dhënë më 8 mars 2011 (“vendimi kryesor”), Gjykata u shpreh që ishte shkelur neni 6 paragrafi 1 dhe 13 i Konventës, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit nga ana e autoriteteve të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 15 dhjetor 1999, të interpretuar me vendimin e 18 shkurtit 2005, i cili i njeht kërkueses shpërblim në vend të kthimit të pronës (Eltari kundër Shqipërisë, nr. 16530/06, 8 mars 2011).



3. Meqë pyetja e zbatimit të nenit 41 të Konventës nuk ishte gati për vendim, Gjykata e rezervoi dhe ftoi Qeverinë dhe Kërkuesen që të paraqisnin parashtrimet e tyre me shkrim për këtë çështje dhe sidomos që të njoftonin Gjykatën për ndonjë marrëveshje që ato mund të arrinin.

4. Më 15 shtator 2011, vendimi kryesor u bë përfundimtar dhe palët u ftuan që të paraqesin parashtrimet me shkrim në lidhje me shpërblimin e drejtë.

5. Më 5 janar 2012, Gjykata e shtyu afatin për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim nga qeveria në lidhje me shpërblimin e drejtë.

6. Më 18 janar 2012, kërkuesja paraqiti pretendimet për shpërblimin e drejtë. Bazuar në nenin 41 të Konventës, kërkuesja kërkonte shuma të ndryshme me anë të shpërblimit të drejtë.

7. Më 31 janar 2012, qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme.

8. Më 4 prill 2012, kërkuesja paraqiti komente për deklaratën e njëanshme të qeverisë.

9. Më 31 korrik 2013, qeveria i paraqiti Gjykatës, si pjesë e informacionit të përgjithshëm, hartat e reja të vlerës së pronave, të cilat ishin miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187 të 6 marsit 2013.

E DREJTA

10. Në pretendimet e saj për shpërblim të drejtë më 18 janar 2012, kërkuesja kërkonte shpërblim sepse kishte humbur pjesën së saj të parcelës së tokës prej 521 m². Meqenëse kjo parcelë toke ndodhej në qendër të qytetit bregdetar të Vlorës, ajo parashtroi që çmimi i referencës ishte 600 euro ("EUR") për metër katror. Kështu që ajo kërkoi 312,600 euro në lidhje me dëmin monetar. Në lidhje me dëmin jomonetar ajo kërkoi 15,000 euro. Në lidhje me shpenzimet dhe kostot ligjore kërkuesja kërkoi 7,000 euro për kosto dhe shpenzime për shkak të proceseve gjyqësore të brendshme dhe 2855 euro për shpenzimet dhe kostot për proceset sipas Konventës. Nga shuma e fundit, duhet të zbritet shuma prej 850 euro e dhënë nga Këshilli i Europës si ndihmë ligjore.

11. Në pamundësi për një zgjidhje me pajtim ndërmjet palëve, siç e parashikon paragrafi 104 i vendimit kryesor, më 31 janar 2012, Qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme që lexon, aq sa është e rëndësishme, si më poshtë (ekstraktet e rëndësishme të marra nga varianti anglisht, siç është paraqitur nga Qeveria):

"Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e përgatitur që t'i paguajë (...) znj. Zamira Eltari (...) shumë prej 3000 eurosh (tre mijë euro) për të mbuluar dëmin jomonetar dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, plus tarifa që mund të vihen ndaj kërkueses.

Në lidhje me dëmin monetar, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e përgatitur që të shpërblejë kërkuesen me shumë 6,252,000 (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, si shpërblim për 521 metër katrorë në pronësi të kërkueses, bazuar në hartat e vlerës¹, që tregojnë se çmimi për metër katror në parcelën e sipërpërmendur është 12,000 (dymbëdhjetë mijë) lekë për metër katrorë.

Shuma prej 3000 (tre mijë) eurosh do të konvertohet në lek me kursin e këmbimit ditën e marrëveshjes.

Shumat e mësipërme do të paguhen brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata sipas nenit 37, paragrafi 1, të Konventës. Në rast mospagimi të këtyre shumave brenda periudhës në fjalë, Qeveria do të paguajë interesat që lindin nga mbarimi i kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tri pikë përqindje. Kuptohet që pagesat e mësipërme do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të konfliktit."

12. Në komentet e saj për deklaratën e njëanshme të Qeverisë, më 4 prill 2012, kërkuesja pretendon që kërkesa e saj ka të bëjë me pjesën e saj në parcelën e tokës, pra 521 m². Ajo parashtron që sipas vendimit të Qeverisë nr. 1620 të 26 nëntorit 2008, çmimi i referencës vërtet ka qenë 12,000 lekë për m². Megjithatë, ky çmim reference është përgjysmuar krahasuar me çmimin e referencës në vendimin e qeverisë nr. 555 të 29 gushtit 2007, pra 25,597 lekë për m² (përafërsisht 179 sipas kursit të këmbimit më 4 prill 2012). Ky përgjysmim është bërë brenda një viti dhe qeveria nuk ka paraqitur argumente që ta justifikojnë këtë përgjysmim. Ajo kërkoi që çmimi i zbatueshëm i referencës të jetë 25,597 lekë për m². Më tej, ajo kërkoi 15,000 euro për dëm jomonetar. Kërkuesja tërhoqi pretendimin e saj për kosto dhe shpenzime ligjore të kryera në proceset gjyqësore të brendshme, për shkak të pamundësisë për ta provuar, por iu qëndroi pretendimeve në lidhje me kostot dhe shpenzimet e kryera në proceset në Strasburg, nga të cilat duhet të zbriten 850 euro.

1. Hartat e mësipërme të vlerës së pronave parashikohen me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1620, datë 26.11.2008 "Miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna".



13. Gjykata vëren që neni 37 i Konventës parashikon që në çdo fazë të procesit gjyqësor mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë nga listat e saj të çështjeve ku rrethanat çojnë në një nga përfundimet e specifikuara sipas paragrafit 1 (a), (b) ose (c). Neni 37 paragrafi 1 mundëson që Gjykata të çregjistrojë një çështje nga lista e saj sidomos nëse:

“(c) “për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”

Neni 37 paragrafi 1 in fine përmban dispozitën që:

“Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollet e saj.”

14. Gjykata vëren, gjithashtu, që në rrethana të caktuara, mund të çregjistrojë një kërkesë ose një pjesë të saj, sipas nenit 37 paragrafi 1 të Konventës në bazë të një deklarate të njëanshme. Madje, asnjë gjë nuk e pengon një shtet të paditur që të paraqesë një deklaratë të njëanshme në lidhje me, si në rastin në fjalë, procedurën e nenit 41 të rezervuar. Për këtë qëllim, Gjykata do të shqyrtojë me kujdes deklaratën e Qeverisë nisur nga parimet e përgjithshme të zbatueshme në lidhje me nenin 41 të Konventës (shihni mes të tjerash, *Bushati dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (shpërblim i drejtë - çregjistrimi), nr. 6397/04, paragrafi 10, 14 shkurt 2012).

15. Gjykata në konstatimin e saj rikujton që në çështjen *Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (shpërblim i drejtë) nr. 35720/04 dhe nr. 42832/06, §§ 33-39, 7 dhjetor 2010, llogaritja e dëmit monetar bazohet në hartën e vlerës së pronave.

16. Më 31 korrik 2013, Qeveria i paraqiti Gjykatës hartën e vlerës së pronave 2013 (shihni paragrafin 9 më sipër). Gjykata vëren që harta e vlerës së pronave është paraqitur për informacion të përgjithshëm, jashtë afatit, pas mbylljes së procedurës së shkruar. Qeveria nuk bën ndonjë parashtrim të shprehur në lidhje me përdorimin e këtyre hartave për këtë kërkesë. Qeveria nuk specifikon vendndodhjen e parcelës së tokës në zonat kadastrale përkatëse në përputhje me hartën e vlerës së pronave 2013 dhe çmimin e referencës që duhet të aplikohet në lidhje me këtë kërkesë. Për më tepër, Qeveria nuk tregon nëse çmimi i referencës pasqyron vlerën reale të tregut dhe “është indeksuar me interesin dhe inflacionin” (krahasoni *Vrioni dhe të tjerë* (shpërblim i drejtë) përmendur më sipër, paragrafi 37). Në këto

rrethana, Gjykata nuk mund të bazojë llogaritjen e saj të dëmit monetar në hartën e vlerës së pronave të miratuar nga Qeveria në vitin 2013.

17. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që në bazë të hartës së vlerës së pronave 2008, çmimi i referencës i parcelës së tokës së kërkuësës ishte 12,000 lekë m². Kërkuësja e kundërshton zbatimin e këtij çmimi reference dhe propozon që të zbatohet çmimi i referencës në hartën e vlerës së pronave 2007, pra 25.597 lekë m² (përafërsisht 179 euro).

18. Pas shqyrtimit të hartës së vlerës së pronave 2008, Gjykata vëren që çmimi i referencës është ulur për të gjitha parcelat e tokave në qytetin bregdetar të Vlorës, krahasuar me hartën e vlerës së pronave 2007. Ndërsa Qeveria mund të kishte dhënë arsye që të justifikonin këtë ulje, kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë raport ekspertit apo nuk është mbështetur në ndonjë alternativë tjetër për llogaritjen e çmimit të referencës. Gjykata më tej vëren që kërkuësja nuk ka qenë e qëndrueshme në lidhje me pretendimin e saj për dëmin monetar, pa ndonjë arsye të fortë. Në fillim ajo pretendoi që çmimi i referencës ishte 600 euro për metër katrorë, pa e mbështetur këtë shifër me një raport ekspertit. Në komentet e saj për deklaratën e njëanshme të Qeverisë, ajo shprehet e gatshme të pranojë një çmim reference të ulur deri në 179 euro m². Në këto rrethana, Gjykata e refuzon propozimin e kërkuësës dhe është e përgatitur që të pranojë çmimin e referencës që tregon harta e vlerës së pronave 2008. Prandaj, Gjykata pranon deklaratën e njëanshme të qeverisë në lidhje me shpërblimin për dëmin monetar në shumën 44000 euro (ekuivalente me 6252000 lekë).

19. Gjykata shqyrton, gjithashtu, pretendimin e kërkuësës në lidhje me dëmin jomonetar dhe e konsideron të tepruar. Në këtë drejtim, Gjykata është e përgatitur që të pranojë propozimin e qeverisë për t'i dhënë 3000 euro për dëmin jomonetar.

20. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet ligjore, Gjykata vëren që më 4 prill 2012, kërkuësja e ka tërhequr pretendimin për kostot dhe shpenzimet e kryera në proceset gjyqësore të brendshme. Sa u përket shpenzimeve dhe kostove në proceset gjyqësore në Strasburg, Gjykata vëren që as më 18 janar as më 4 prill 2012 kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë faturë në mbështetje të pretendimit të saj. Gjykata është e bindur që kërkuësja i janë dhënë 850 euro si ndihmë juridike nga Këshilli i Europës.



21. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme dhe shumën e shpërblimit të propozuar nga Qeveria, e cila duket se në këtë rast është e arsyeshme, Gjykata konsideron se nuk ka më arsye për të vazhduar shqyrtimin e çështjes (neni 37 paragrafi 1 (c)). Nisur nga të gjitha konsideratat e mësipërme, Gjykata është e bindur që respektimi i të drejtave të njeriut i përcaktuar në Konventë dhe protokolle nuk kërkon që ajo të vazhdojë shqyrtimin e çështjes (neni 37 paragrafi 1 në formë të përmbledhur). Prandaj, duhet të çregjistrohet nga lista në lidhje me procedurën për nenin 41 të rezervuar.

22. Në përputhje me rregullin 43, paragrafi 3, të Rregullores së Gjykatës, ky vendim do t'i përcillet Këshillit të Ministrave, me qëllim që ky i fundit të mbikëqyrë, sipas nenit 46, paragrafi 2, të Konventës, ekzekutimin e angazhimeve të Qeverisë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI,

1. Mban parasysh afatet e deklaratës së qeverisë së paditur dhe në vazhdimësi orienton, që:

a) Shteti i paditur t'i paguajë kërkuueses 44 000 euro (dyzet e katër mijë euro) brenda tre muajve nga data që ky vendim merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44, paragrafi 2, të Konventës, për dëmin monetar, plus çdo tarifë të mundshme për konvertimin në valutën kombëtare të shtetit të paditur sipas kursit të këmbimit ditën që do të bëhet pagesa;

b) Shteti i paditur t'i paguajë kërkuueses 3000 euro (tre mijë euro) brenda tre muajve nga data që ky vendim merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44, paragrafi 2, të Konventës, për dëmin jomonetar, plus çdo tarifë të mundshme për konvertimin në valutën kombëtare të shtetit të paditur sipas kursit të këmbimit ditën që do të bëhet pagesa;

c) Nga mbarimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme, në normën e barabartë me normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europian.

2. Vendos, njëzëri, të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve për procedurën e nenit 41 të rezervuar.

Bërë në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 10 qershor 2014, sipas Rregullit 77, paragrafët 2 dhe 3, i Rregullores së Gjykatës.

ZËVENDESESSEKRETAR

Fatoş Aracı

PRESIDENT

Ineta Ziemel

KËRKESË

Nr. 6755/9, datë 18.12.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “ndërtim, tokë bujqësore arë, truall, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 400 kV, Vau i Dejës-Morinë”.

Subjekti kërkuës i këtij shpronësimi është “OST” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve, nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I ENERGJISË DHE
INDUSTRIË
Damian Gjijnuri



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 400 kV VAU DEJËS - MORINË

Qarku: Shkodër, Kukës

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Ndërtim, tokë arë, truall, kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit për banesë m ²	Sip. e shpronësimit për shtyllë m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë për banesë	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m ²						
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Komuna Vau Dejës														
Karme														
1	26	Pretendues			2097	112	Arë	10190		140	225		31500	
2	27	Pretendues			2097	154	Arë	133700		105	225		23625	
Ndërmjet 26-27		Pretendues			2097	130	Shtëpi banimi		85		28175	2394875		Pa certifikatë pronësie
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										245				
Vlera totale në lekë												2394875	55125	
Fshati Karme														
3	34	Pretendues			2098	3	Arë	7017		97	225		21825	
							Truall	200						
4	35	Mark	Marash	Zefi	2098	289	Arë	1700		140	225		31500	
5	36	Gjon	Marash	Zefi	2098	289	Arë			208	225		46800	
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										445				
Vlera totale në lekë													100125	
Komuna Koman														
Koman														
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi banimi		165		28175	4648875		Nuk ka informacion
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi banimi		93		28175	2620275		Nuk ka informacion
Sipërfaqja totale ndërtimi për shpronësimi m ²									258					
Vlera totale në lekë												7269150		
Komuna Qelëz														
Fshat Bushat														
6	72	Prendush	Pal	Vata	1330	223	Arë	1500		108	100		10800	
7	73	Pjeter	Mark	Kola	1330	175	Arë	1300		133	100		13300	
8	74	Ndue	Pal	Vata	1330	127	Arë	11250		133	100		13300	
9	75	Pretendues			1330	336	Arë	3125		87	100		8700	
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										461				
Vlera totale në lekë													46100	
Komuna Iballë														
Fshati Berishe Vendi														
10	86	Pretendues			1163	322	Arë	796		105	100		10500	
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										105				
Vlera totale në lekë													10500	
Fshati Berishe e Vogël														
11	89	Pretendues			1162	493	Arë	4236		140	100		14000	
12	90	Pretendues			1162	355	Arë	120		97	100		9700	
13	91	Pretendues			1162	244	Arë	832		133	100		13300	
14	92	Pretendues			1162	244	Arë	832		118	100		11800	
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										488				
Vlera totale në lekë													48800	



Fshat Shopel													
15	96	Prendush	Frrok	Kola	3402	146	Arë	2503		133	100		13300
					Sipërfaqja totale shpronësimi m²				133				
					Vlera totale në lekë							13300	
Fshati Berishe e Sipërme													
16	106	Pretendues			1160	861	Arë	7768		117	100		11700
17	107	Pretendues			1160	861	Arë	7768		133	100		13300
18	111	Pretendues			1160	199	Arë	289		150	100		15000
19	112	Pretendues			1160	19	Arë	1556		165	100		16500
					Sipërfaqja totale shpronësimi m²				565				
					Vlera totale në lekë							56500	
Komuna Bugjon													
Fshat Bugjon													
20	117	Pretendues			1300	917	Arë	12331		140	100		14000
21	118	Pretendues			1300	827	Arë	5499		117	100		11700
22	119	Gjelosh	Stak	Sheqeri	1300	703	Arë	2503		117	100		11700
23	120	Mark	Mic	Sokoli	1300	612	Arë	1613		149	100		14900
24	121	Gjin	Lek	Pjetri	1300	349	Arë	707		149	100		14900
					Sipërfaqja totale shpronësimi m²				672				
					Vlera totale në lekë							67200	
Komuna Fierze													
25	128	Pretendues			1619	526	Arë	972		118	100		11800
26	129	Pretendues			1619	372	Arë	1446		87	100		8700
27	130	Mhill	Nik	Bala	1619	131	Arë	3931		133	100		13300
					Sipërfaqja totale shpronësimi m²				338				
					Vlera totale në lekë							33800	
											9664025	431450	
Sipërfaqja total. shpronësimi për shtylla 3452 m² me vlerë totale në lekë 431 450											Shuma totale	10095475	
Sipërfaqja total. shpronësimi për ndërtim 343 m² me vlerë totale në lekë 9 664 025													

**KËRKESË****Nr. 7461/3, datë 18.12.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë, truall”, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV, Zemblak-Korçë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “OST” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës, të llogaritur nga

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

**MINISTRI I ENERGJISË DHE
INDUSTRIË
Damian Gjijnuri**

Bashkia: Korçë**Komuna: Pojan, komuna Qendër****Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë bujqësore arë, truall**

Numri i shtyllës	Emri, atësia, mbiemri			Të dhëna për pronësinë				Vlera ne leke/m ² sipas ll. të pasurisë	Vlera sip. e shpronësimit lekë	Shënime	
				Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. pronës m ²				Sip. e shtyllës shpronësim m ²
1	2			3	4	5	6	7	8	9	10
QARKU KORÇË											
Komuna Pojan											
Fshati											
Zëmbllak											
1	Pretendues			Arë	3903	112/28		152	212	32224	nuk ka informacion
1	Pretendues			Arë	3903	112/29					
2	Pretendues			Arë	3903	109/21		62	212	13144	nuk ka informacion
3	Kujtim	Veli	Bregu	Arë	3903	117/7	660	62	212	13144	
4	Rahmi	Mahmut	Myftarlli	Arë	3903	117/75	1073	62	212	13144	
4	Muhamet	Rakip	Myftarlli	Arë	3903	117/78	1206				
5	Sali	Abaz	Sotomeni	Arë	3903	120/13	2025	62	212	13144	
5	Pellumb	Ibrahim	Kulla	Arë	3903	120/16	1296				
6	Virjon		Lilollari	Arë	3903	129/43	568	71	212	15052	
6	Guradem	Selfo	Bregu	Arë	3903	129/44	1211				
7	Pellumb	Ilmi	Shpata	Arë	3903	129/72	5930	62	212	13144	
7	Agim	Ilmi	Shpata	Arë	3903	129/73	6972		212	212	
8	Seit	Islam	Dido	Arë	3903	76/1/17	890	152	212	32224	
9	Nuri		Muca	Arë	3903	75/1/10	6750	62	212	13144	
9	Medat	Dilaver	Burnazi	Arë	3903	75/1/11	7787				
Fshati											
Plasë											
10	Shaban	Kasem	Arap	Arë	2984	73/47	2430	62	212	13144	
11	Tafil	Ismail	Korkuti	Arë	2984	73/17	2940	75	212	15900	
12	Jani	Avdyl	Mele	Arë	2984	70/68	1592	62	212	13144	
12	Urim	Avdyl	Fezolli	Arë	2984	70/69	1500				
13	Sali	Mustafa	Agolli	Arë	2984	65/17	960	62	212	13144	
13	Ramadan	Gurali	Uci	Arë	2984	65/18	1050				
				Sipërfaqja totale shpronësimi m ²				1008			
				Vlera totale në lekë për komunën Pojan				213908			
Komuna Qendër (Bulgarec)											

**KËRKESË****Nr. 7703, datë 19.12.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Pushimi i Shoferit - Divjakë”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë” dhe “truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 7 258 280 (shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Fletorja Zyrtare



Viti 2014 – Numri 197

323	Figëri	Abdulla	Bilishti	2700	1550/5	Arë	6085	17	502	8534		8534	Konf. ZVRPP
324	Bajram	Isa	Maxhuri	2700	1008/96	Arë	385	76	502	38152		38152	Konf. ZVRPP
325	Bashkim	Sami	Godumi	2700	40	Arë	516	66	502	33132		33132	Konf. ZVRPP
326	Kadri	Sami	Godumi	2700	41	Arë	538	36	502	18072		18072	Konf. ZVRPP
327	Bilal	Qenam	Zeneli	2700	42	Arë	275	18	502	9036		9036	Konf. ZVRPP
328	Qenam	Bilal	Zeneli	2700	43	Arë	275	20	502	10040		10040	Konf. ZVRPP
329	Dule	Ziza	Bakiasi	2700	33	Arë	694	29	502	14558		14558	Konf. ZVRPP
330	Leftër	Hajredin	Lamçe	2700	32	Arë	460	21	502	10542		10542	Konf. ZVRPP
331	Spiro	Vasil	Mali	2700	1008/86	Arë	972	59	502	29618		29618	Konf. ZVRPP
332	Vasil	Pali	Gjermani	2700	1008/151	Arë	420	25	502	12550		12550	Konf. ZVRPP
333	Nasi	Pali	Gjermani	2700	1008/152	Arë	240	26	502	13052		13052	Konf. ZVRPP
334	Koli	Pali	Gjermani	2700	1008/155	Arë	600	14	502	7028		7028	Konf. ZVRPP
335	Maksim	Koli	Gjermani	2700	1008/154	Arë	408	4	502	2008		2008	Konf. ZVRPP
336	B/P		Mali	2700	1008/200	Truall	8662	93			396	36828	Me AKKP
337	B/P		Libofsha	2700	982/60	Truall		43			396	17028	Konf. ZVRPP
338	B/P		Libofsha	2700	982/59	Truall		26			396	10296	Konf. ZVRPP
339	B/P		Libofsha	2700	982/58	Truall		40			396	15840	Konf. ZVRPP
	Bashkia Divjakë, Fshati Xengë, ZK 3848												
340	Argjil	Trifon	Tapanxha	3848	917/4	Arë	2204	30	502	15060		15060	Konf. ZVRPP
341	Iorgji	Nasi	Zaka	3848	917/5	Arë	3332	55	502	27610		27610	Konf. ZVRPP
342	Spiro	Lazi	Veliu	3848	917/6	Arë	5194	111	502	55722		55722	Konf. ZVRPP
343	Jovan	Lazi	Veliu	3848	917/7	Arë	1915	88	502	44176		44176	Konf. ZVRPP
344	Durim	Fari	Kajo	3848	917/6	Arë	735	116	502	58232		58232	Konf. ZVRPP
345	Petraç	Koli	Tapanxha	3848	919/31	Arë	1460	68	502	34136		34136	Konf. ZVRPP
346	Minella	Koli	Tapanxha	3848	919/30	Arë	1460	44	502	22088		22088	Konf. ZVRPP
347	Ilir	Koli	Tapanxha	3848	919/29	Arë	1350	34	502	17068		17068	Konf. ZVRPP
348	Mario	Koli	Tapanxha	3848	919/28	Arë	2314	74	502	37148		37148	Konf. ZVRPP
349	Ylli	Koli	Tapanxha	3848	919/2	Arë	1914	57	502	28614		28614	Konf. ZVRPP
350	I Pa Indentifikuar			3848	912/73	Arë		41	502	20582		20582	Konf. ZVRPP
351	I Pa Indentifikuar			3848	912/75	Arë	705	48	502	24096		24096	Konf. ZVRPP
352	Nikoll	Ndini	Gjeka	3848	912/58	Arë	640	21	502	10542		10542	Konf. ZVRPP
353	B/P		Bejdollari	3848	866/20	Arë	968	30	502	15060		15060	Konf. ZVRPP
	Bashkia Divjakë, ZK 1492												
354	Llamber	Ristan	Naci	1492	777/1	Arë	4952	57	183	10431		10431	Konf. ZVRPP
355	Gjergji	Ristan	Naci	1492	777/2	Arë	4965	72	183	13176		13176	Konf. ZVRPP
356	Sefedin	Mane	Shehu	1492	777/3	Arë	5036	66	183	12078		12078	Konf. ZVRPP
357	Adrian	Sefedin	Shehu	1492	777/4	Arë	2018	31	183	5673		5673	Konf. ZVRPP
358	B/P		Tashi		777/6+7	Arë		61	183	11163		11163	Konf. ZVRPP
								15671					
		SHUMA LEKË						15671		7E+06		1E+05	7E+06



Tabelat plotësuese të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 26, datë 16.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22.12.2014, f. 10787.



**Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve**

(NVD)

Kerkese per Regjistrim

Ju lutem lexoni shënimet në faqen 4 para se të plotësoni formularin. Përdorni gërma KAPITALE

NIPT-i

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

(1) Emri i tatimpaguesit

Shih shenimin 1

(2) Emri tregtar

(3) Administratori/ Perfaqesuesi (shenim 3)

(3/1) Nr I ID

(4) Adresa e personit / administratorit / Perfaqesuesit Rruga dhe numri , Qyteti ose fshati Rrethi

(5) Pronesia

Shih shenimin 5

Shqiptare private

☐

Shqiptare shtetërore

☐

E huaj

☐

E perbashket

☐

(6) Forma ligjore

Shih shenimin 6

OJF

☐

Ent publik

☐

Org. Politike

☐

Ambulant

☐

Org. Fetare

☐

Kryefamiljar

☐

P. Tatimor

☐

Trup Diplomatik

☐

Nj. Zbat. Projekte

☐

P. Bujqesor

☐

(7) Data e krijimit

NR. i dokumentit

Institucioni

Shih shenimin 7

(8) Adresa kryesore Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Shih shenimin 8

Kontakte

Tel/cel

E mail

(9) Aktiviteti

Shih shenimin 9

(10) Kodi ekonomik

Shih shenimin 10

Kjo fushe plotësohet nga insp. tatimeve

Kode te tj



(11)
Jam i regjistruar
per :

☐ Tatim fitimi

☐ TVSH

☐ Sigurimet Shoqerore

☐ Tatim i Thjeshtuar mbi fitimin-
Fitimin

☐ Tatimi/te Ardhurat nga Punesimi

☐ Tatimi ne burim

☐ Tatim Lojrat e fatit

☐ Taksa Nacionale

☐ Renta Minerare

☐ Tarifat

☐ Akciza

☐ Te tjera

Shih shenimin 11

(12)
Kategoria per efekt
sigurimesh

☐ Punedhenes

☐ I vetepunesuar

Shih shenimin 12

(13) Xhiro parashikuar
Per vitin nga data

Shih shenimin 13

(14) Fitimi i parashikuar

Shih shenimin 14

(15) Adre-
sat e tjera
ku kryhet
biznesi

Shih
shenimin
15

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi	Nr. certifikates

(16) Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur
Shtojca A , eshte i vertete.

Shih shenimin 16

(17) Emri,mbiemri,
nenshkrimi dhe data

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Shih shenimin 17

Per perdorim zyrtar

Verifikuar nga inspektori: Emri, Mbiemri

Nenshkrimi

Kodi

(NVD)

NIPT-i

[illegible]

Shih
shenimin 15

[illegible]



**Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve**

Disa subjekteve ju kërkohet të regjistrohen në Organet Tatimore dhe të pajisen me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT). Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet përpara se veprimtaria ekonomike të fillojë. Cilido person që është i detyruar të regjistrohet dhe nuk regjistrohet, ka kryer një shkelje dhe për këtë do të zbatohen gjobat sipas ligjit perkates.

Plotesimi i formularit

Fusha e parë e formularit është fusha e NIPT-it. Kjo fushë plotësohet nga organet tatimore.

- (1) **Emri tatimpaguesit** : Duhet të jepni emrin e plotë të tatimpaguesit, siç tregohet në dokumentin e regjistrimit në Gjykatë ose e përcaktuar në akte të tjera ligjore. Ky do të jetë emri juaj në rast se jeni ambulant apo kryefamiljar .
- (2) **Emri Tregtar** : Emer i perdorur nga tatimpaguesi ne kursin e tregut, i cili mund te jete i ndryshem nga emri i regjistruar si tatimpagues.
- (3) **Administratori** : Jepni emrin e pronarit/administratorit/drejtorit të tatimpaguesit apo perfaqesuesit tatimor përcaktuar ne dokumentin përkatës. Nëse jeni një person fizik (ambulant apo kryefamiljar) ky do të jetë emri juaj.
- (4) **Adresa e1 administratorit** : Jepni adresën personale të pronarit/administratorit/drejtorit apo perfaqesuesit emri i të cilit është paraqitur më lart.
- (5) **Pronësia** : Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj.
- (6) **Forma ligjore** : Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj.
- (7) **Data e krijimit, Nr I Dokumentit, Institucioni** : Jepni datën e regjistrimit, numrin e dokumentit dhe Institucionin qe e ka leshuar ate, ndërsa për ambulantët dhe kryefamiljarët datën e plotësimit te formularit.
- (8) **Adresa kryesore** : Jepni adresën në të cilën drejtoni apo ushtroni veprimtarinë tuaj. Nëse keni më shumë se një vendodhje të veprimtarisë ekonomike duhet të caktoni njërën prej tyre si adresë kryesore. Nëse jeni ambulant, apo kryefamiljar jepni adresën tuaj private. Jepni numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike nëse keni, në mënyrë që të mund t'ju njoftojmë për ndryshimet e mundshme që mund të ndikojnë mbi ju.
- (9) **Aktiviteti** : Jepni pershkrimin me fjale të aktivitetit tuaj të përcaktuar nga Gjykata ose nga i vetepunesuari në rastin e ambulantit. Per kryefamiljarin jepni llojin e punes te personit te punesuar nga ju.
- (10) **Kodi ekonomik** : Kjo fushë plotësohet nga zyra e DRT, mbi bazën e "Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike"
- (11) **Jam i regjistruar për** : Zgjidhni të gjitha kutitë për tatimet që jeni të detyruar të paguani. Në rast vështirësie kërkoni ndihmën e inspektorëve të regjistrimit në DRT përkatëse.
- (12) **Kategoria për efekt sigurimesh** : Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj
- (13) **Xhiro e parashikuar** : Jepni xhiron që parashikoni të realizoni në vitin e parë të aktivitetit tuaj ekonomik, kjo për OJF, jo për ambulantet dhe kryefamiljarët.
- (14) **Tatimi i parashikuar** : Këtë fushë duhet ta plotësoni vetëm nëse kërkoni të regjistroheni për këtë tatim.
- (15) **Adresat e tjera** : Nëse subjekti juaj (perjashtuar ambulantet) operon në më shumë se një adresë, duhet që në këtë tabelë të jepni të dhënat e secilës adresë, me përjashtim të adresës kryesore. Nëse nuk keni vend të mjaftueshëm në formular duhet të plotësoni shtojcën A. Për secilën nga adresat ju do të pajiseni me certifikatën e regjistrimit.
- (16) **Deklarimi** : Zgjidhni kutitë përkatëse nëse keni plotësuar shtojcën A të këtij formulari.
- (17) **Nënshkrimi dhe data** : Deklarimi duhet të bëhet nga pronari, administratori ose personi i autorizuar të veprojë në emër të subjektit. Ligji parashikon dënime në rastet e deklarimit të pasaktë apo dezinformues.

Detyrimet në të ardhmen:

Për çdo ndryshim në të dhënat e raportuara në këtë formular duhet të njoftoni drejtorinë rajonale tatimore ku jeni regjistruar, dhe të plotësoni formularin e ndryshimeve në Regjistrim, që do ta gjeni pranë kësaj drejtorie. Për çdo ndihmë apo informacion shtesë kontaktoni me DRT përkatëse ose lexoni www.tatime.gov.al.


**Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve**

(NVD)

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Ju lutem lexoni shenimet ne faqen 4 para se te plotesoni formularin.
Perdorni germa KAPITALE.

NIPT-i

Shih Shenimin 1

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Emri i tatimpaguesit

--

Detaje te ndryshimit Kujdes, duhet te plotesoni vetem ndryshimet.

 Çfare ndryshimesh
po njoftoni?

 Zgjidhni kutine e duhur
dhe vazhdoni sipas
udhezimit

Ndryshim ne detajet e regjistrimit

☐
Shko ne Seksionin 1 me poshte .

Ndryshim i pergjegjesise per tatimet

☐
Shko ne Seksionin 2, ne faqe 2.

Mbyllje e aktivitetit

☐
Shko ne Seksionin 3, ne faqe 3Ndryshim i kategorizimit per sigurimet
shoqerore
☐
Shko ne Seksionin 4, ne faqe 3
Seksioni 1

 [2] Emri i ri
i tatimpaguesit
Shih shenimin 2

--

Emri i ri tregtar

--

 [3] Emri i drejtuesit te ri
Shih shenimin 3

--	--

Nr I ID

--

 [4] Adresa e banimit e
drejtuesit te ri , Rruga dhe
numri , Qyteti ose fshati
Rrethi
Nr. Telefon / e-mail

[5] Pronesia

Shqiptare private ☐Shqiptare shtetërore ☐E huaj ☐E perbashket ☐

Forma Ligjore

SHPK ☐Anonime ☐Zyrë Përfaqësi- ☐Kolektive ☐Org. Politike ☐Njesi. Zbat. Pro- ☐

Shih shenimin 5

Komandite ☐Trup Diplomatik ☐Ortakeri ☐SHBR ☐Shoq.kursim-kredi ☐P. Bujqesor ☐Person fizik ☐OJF ☐Ent publik ☐Perf. Tatimor ☐Ambulant ☐Kryefamiljar ☐Org. ☐
 [6] Adresa kryesore
e biznesit
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

 Shih shenimin 6
Shih shenimin 6

E mail

--

 [7] Aktiviteti i ri
Shih Shenimin 7

--



[8] Kodi i ri ekonomik
Shih shenimin 8

[9] Nese biznesi juaj vepron ne me shume se nje adrese dhe detajet kane ndryshuar, jepni informacion me poshte. **Ju duhet te ktheni certifikaten e NIPT-it per adresen qe eshte mbyllur. Per adresen ekzistuese mund te shenoni vetem numrin e ri te telefonit ose Llojin e ri te veprimtarise. Shih shenimin 9**

Ndryshime ne Adrese
ekzistuese
Shih Shenimin 9

Numri ekzistues i certifikates

Lloji i veprimtarise
ekzistuese

Adrese e mbyllur
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Certifikata bashkengjitur, zgjidh kutine.

☐

Numri i ri i certifikates

Adrese e re

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

Nese ka me shume se nje adrese, vazhdoni me Formularin 3

Seksioni 2

Zgjidh kutine e duhur

[10] Per cilin tatim
jeni pergjegjes
tani?
Shih shenimin 10

☐ Tatim fitimi

☐ TVSH

☐ Sigurimet Shoqerore

☐ Tatim i Theshtuar mbi Fitimin

☐ Tatimi/te Ardhetur nga Punesimi

☐ Tatimi ne Burim

☐ Lojrat e Fatit

☐ Taksat nacionale

☐ Renta Minerare

☐ Tarifat

☐ Akciza

☐ Te tjera

Jepni tatimin dhe qarkullimin e parashikuar me poshte

Qarkullimi i parashikuar
Nga data _____ deri me
date _____

Fitimi i parashikuar

**Seksioni 3**

[11] Data e mbylljes
Shih shenimin 11

--	--	--	--	--	--

Zgjidh kutine e duhur

Arsyeja e mbylljes

Mbyllur ☐Perthithur ☐Aplikim per mbyllje ☐Te tjera ☐

Kur veprimtaria përthithet, emri i shoqërisë përthithëse, NIPT– i dhe adresa

Shoqëria

NIPT-i

Adresa

[12] Kalim ne pasiv
Shih shenimin 12

Kalim ne pasiv me kerkese te subjektit ☐Kalim ne pasiv nga administrata ☐

--	--	--	--	--	--

[13] Riaktivizim nga pasivi
Shih shenimin 13

Riaktivizim me kerkese te subjektit ☐Riaktivizim nga administrata ☐

--	--	--	--	--	--

Seksioni 4

[14]
Kategoria per efekt sigurimesh
Shih Shenimin 14

☐ Punedhenes☐ I vetepunesuar (I vetem)☐ I vetepunesuar me punemarres☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes
☐

[15]

Deklarim

Shih shenimin 15

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur eshte i plote dhe i sakte.

(Emri, mbiemri, nenshkrimi dhe data

--	--	--	--	--	--

[16] **Per plotesim nga inspektori**

Verifikuar nga inspektori: Emri, Mbiemri

Nenshkrimi

Kodi

Data



**Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve**

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Këtë formular duhet t'a përdorni për të njoftuar organin tatimor për ndonjë ndryshim që ndikon në regjistrimin tuaj. Duhet të njoftoni vetëm ndryshimet në të dhënat që keni raportuar në kërkesën për regjistrim. Për të bërë këto njoftime ekzistojnë disa kufinj kohorë. Nëse kryeni blerje ose shitje të tërë subjektit apo pjesë të saj duhet të njoftoni menjëherë organin tatimor. Për ndryshi-met e tjera, njoftimi duhet bërë brenda 15 ditësh nga momenti i kryerjes së ndryshimit.

Tatimpaguesi që janë subjekt I QKR do të deklarojë dhe kryejë ndryshimin e përgjegjësi-ve tatimore dhe kategorisë për sigurime në organet tatimore

Plotesimi i formularit

Shenim 1 : Shkruani NIPT-i dhe emrin e tatimpaguesit.

Shenimi 2 : jepni emrin e ri të tatimpaguesit (vetëm për ata që janë subjekt i organeve tatimore).

Shenimi 3 : Nëse kemi një ndryshim në ortakun kryesor apo drejtorin, apo një tjetër person është tashmë i autorizuar të veprojë në emër të subjektit, shënoni të dhënat e personit të ri, duke përfshirë emrin dhe adresën e plotë postare të banesës private.

Shenimi 4: Nese kemi nje ndryshim ne adresen e banimit te drejtuesit jepni adresen e re te banimit dhe nr. telefonit.

Shenimi 5 : Tregoni pronesine dhe formen e re ligjore te tatimpaguesit.

Shenimi 6: Nese kemi nje ndryshim ne adresen kryesore te biznesit jepni adresen e re dhe nr. telefonit.

Shenimi 7 : Nëse veprimtaria ekonomike kryesore e subjektit ndryshon, shënoni këtu hollësitë.

Shenimi 8. Kjo fushe plotësohet nga inspektori tatimor kur saktësohet ose kur ka ndryshuar veprimtaria ekonomike.

Shenimi 9 : (vetëm për ata që janë subjekt i organeve tatimore). Për çdo degë të subjektit lëshohet një certifikatë NIPT-i e re. Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT-i) me të cilin jeni i pajisur nuk ndryshon, por certifikatat do të kenë të gjitha nga një numër të ndryshëm.

Nëse një degë ekzistuese mbyllet **ju duhet të ktheni certifikatën e NIPT-it në DRT**. Anasjelltas, kur hapet një degë e re, organi tatimor do të lëshojë një certifikatë NIPT-i në lidhje me atë degë.

Pasi të keni hapur degën e re, jepni të dhënat e veprimtarisë së biznesit që ushtrohet aty. Nëse nuk keni hapësirë të mjaftueshme për të gjithë informacionin, përdorni Shtojcën A.

Shenimi 10 : Spontoni kutinë përkatëse për të gjitha tatimet për të cilat cilin detyroheni të deklaroni dhe/ose paguani **tani**, dhe shënoni të dhënat lidhur me tatimin e parashikuar dhe qarkullimin.

Nëse qarkullimi për vitin e fundit kalendarik e tejkalon vlerën prej 8 milion lekë, ju duhet të bëni kërkesë për t'u regjistruar për Tatimin mbi Fitimin. Nëse qarkullimi për vitin e fundit tejkalon vlerën mbi 2 milionë lekë për profesionet dhe mbi 5 milionë lekë për aktivitetet e tjera, pavarësisht se jeni në Biznes të Vogël, ju duhet të kërkonti për tu regjistruar në TVSH. Mos vononi, në të kundërt do të penalizoheni me gjobë. Nëse keni Biznes i Vogël dhe qarkullimi vjetor parashikohet në vlerën 2-8 milionë lekë atëherë ju duhet të regjistroheni për Tatimin mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël.

Shenimi 11 : Nëse veprimtaria ekonomike është shitur, mbyllur , perthithur, ose eshte kryer aplikimi per mbyllje prane QKR , Gjykates etj, shënoni datën dhe spontoni kutinë përkatëse për të dhënë arsyt e mbylljes së veprimtarisë. Ne rastin e aplikimit per mbyllje spontimi i kutise perkatese do te kete si efekt nderprejen e gjenerimit te deklaratave tatimore.

Shenimi 12. Nese jane plotesuar kushtet per kalim ne pasiv spontoni kutine dhe vendosni daten.

Shenimi 13. Nese jane plotesuar kushtet per riaktivizim nga pasivi spontoni kutine dhe vendosni daten.

Shënim 14 : Nëse kategorizimi juaj për efekt të sigurimeve shoqërore apo TAP ka ndryshuar, zgjidhni vetëm njërin nga kutitë përkatëse për kategorinë që ju keni tashmë.

Shenimi 15: Nese informacioni i dhene eshte i sakte dhe i plote, nenshkruani formularin dheplotesoni daten.

Shenimi 16. Kjo pjese plotësohet nga inspektori i DRT.

Detyrimet ne te ardhmen

Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni DRT ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni drejtorinë rajonale të

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë